1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të

vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots + On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					

Datë _____	
------------	--

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacione nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të

produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

“SHËRBIMI I TRANSPORTIT, SHOQËRIMIT DHE RUAJTJES SË VLERAVE MONETARE GJATË TRANSPORTIT, ME ROJE TË KATEGORISË 1.3.B”

ME MJETE TË BLINDUAR TË SHOQËRISË DHE PUNONJËS SHËRBIMI TË SHPRSF PËR LLOGARI TË POSTËS SHQIPTARE SH.A, NGA BANKAT NË FILIAL, DEGË DHE NË TË GJITHA ZYRAT POSTARE.

- Grupi i shoqërimit të vlerave monetare të SHPRSF-së duhet të jetë i përbërë nga punonjës të certifikuar në kategorinë 1.3.B të cilët duhet të jenë të pajisur me mjete mbrojtëse, antiplumba, armë zjarri, municion, pranga, uniformë dhe dokument identifikimi ashtu siç parashikohet në Ligjin Nr.75/2014 “Për Shërbimin Privat të Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike” si dhe udhëzimet në fuqi.
- Ky Grup duhet të transportojë dhe shoqërojë vlerat monetare që i janë besuar dhe të siguroj jetën e personelit gjatë transportit të vlerave monetare. Detyra e tij funksionale është Shoqërimi i sigurtë i vlerave monetare dhe punonjësve nga Filialet e Postës Shqiptare sh.a, drejt Filialeve të Bankave respektive në Filiale , Degët dhe në Zyrat Postare.
- Për transportin e vlerave monetare Ofertuesi duhet të pajisë punonjësit e shërbimit me armë sipas përcaktimeve ligjore të Ligjit Nr.75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”.
- Shoqërimi dhe transporti duhet të kryhet nga mjeti i Blinduar i kompanisë, mjeti duhet të jetë i blinduar, i loguar në gjëndje të rregullt teknike dhe dokumentare që të kryejë shoqërimin e vlerave monetare. Automjetet e blinduara që transportojnë vlera monetare e sende të çmuara duhet të jenë në përputhje me standartet e kërkuara. Automjetet e blinduara që transportojnë vlera monetare e sende të çmuara sipas kërkesës të AK, duhet të qarkullojnë në të gjitha rrugët e asfaltuara të nënshkruara dhe të vendosura nga AK.
- Shoqërimi i vlerave monetare do të kryhet sipas vëndndodhjes së Filialeve të **Postës Shqiptare sh.a.**, të përcaktuar në Tabelën e publikuar nga Autoriteti Kontraktor dhe në zbatim të plotë të instruksioneve të personave përgjegjës të **Postës Shqiptare sh.a.**, me grafik shërbimi përkatësisht nga dita e Hënë - Premte dhe për qytetin e Tiranës nga dita e Hënë - Shtunë.
- Koha orare e shoqërimit të vlerave monetare do të jetë :
 - Nga Ora 08.00-16.00
 - Raste të veçanta orar i fillimit të lëvizjeve do të jetë më herët se orari sipërcituar sipas specifikës së Filialit të Postës Shqiptare sipas AK.

- **Ofruesi i Shërbimit SHPRSF duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:**
- Firma private të liçensuara për “Sigurimin, transportin dhe shoqërimin e vlerave monetare e sendeve të çmuara të kategorisë 1.3.B ose Çertifikatë 1.3.B, e lëshuar nga Ministria e Brëndshme konform Ligjit nr. 75 datë 10.07.2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike“, do të përgjigjen detyrimisht të gjitha lëvizjeve të vlerave monetare në 5 ditë pune (nga e Hëna – Premte) në Qarkun përkatës, sipas kërkesave të drejtuesve të Filialit dhe Degëve Postare në varësi. Për Filialin e Postës Tiranë, shërbimi për levizjen e vlerave monetare do të bëhet në 6 ditë pune, (nga e Hëna – Shtunë).
- Në përputhje me legjistacionin në fuqi, transporti dhe shoqërimi i vlerave monetare do të bëhet me mjet të blinduar, shoqërues dhe me punonjës shërbimi sipas udhëzimeve në fuqi.
- Çdo automjet blind të jetë i paisur me çertifikat për normën e blindimit, autorizim nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, me kamera dhe GPS/GPRS, të transmetoj sinjal gjatë lëvizjeve të vlerave monetare në çdo kohë dhe në çdo moment, pa ndërprerje në sallën e monitorimit të SHPRSF.
- Gjatë gjithë kohës së shërbimit punonjësi i Shoqërisë SHPRSF duhet të respektojë rregullat e brëndshme të **Postës Shqiptare sh.a.**

Për kapacitetet teknike dhe profesionale.

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon:

Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 50 (pesëdhjetë) automjete të blinduar *për transportin e vlerave monetare*, mjete të cilat duhet të jenë në pronësi të operatorit ekonomik ose me qera. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Lejet e qarkullimit dhe çertifikat pronësie nga Drejtoria e Transportit Rrugor
- b) Leje Drejtimi e përdoruesit të mjetit të blinduar për çdo mjet.
- c) Çertifikatë e Kontrollit Teknik për secilin mjet .
- d) Sigurim të vlefshëm për secilin mjet.
- e) Taksat vjetore të paguara për secilin mjet.

Numri i mjeteve të blinduara të kërkuara sipas filialeve, si më poshtë, të vërtetohet nga vërtetimi i performancës i lëshuar, nga Drejtoritë e Policisë të secilit Qark.

Për Filialin Tiranë 8 mjete të blinduara.

Për Filialin Durrës 4 mjete të blinduara.

Për Filialin Shkodër 4 mjete të blinduara.

Për Filialin Lezhë 4 mjete të blinduara.

Për Filialin Fier 3 mjete të blinduara.

Për Filialin Berat 3 mjete të blinduara.

Për Filialin Vlorë 3 mjete të blinduara.

Për Filialin Gjirokastrë 3 mjete të blinduara.

Për Filialin Elbasan 5 mjete të blinduara.

Për Filialin Kukës 2 mjete të blinduara.

Për Filialin Mat 3 mjete të blinduara.

Për Filialin Korçë 4 mjete të blinduara.

Për Filialin Sarandë 2 mjete të blinduara.

Për Filialin Lushnjë 2 mjete të blinduara.

-
- Operatori ekonomik duhet të disponojë 50 (pesëdhjetë) Autorizime të vlefshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për përdorimin e mjeteve të blinduara.
 - Operatori ekonomik duhet të disponojë Certifikata të lëshuar nga prodhuesi i mjetit të blinduar (**kompania e specializuar për transformimin e mjeteve nga mjete normale në mjete të blinduara**) dhe Autorizime të vlefshme lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ku të jetë përcaktuar norma e blindimit të mjetit të blinduar për minimalisht 50 (pesëdhjetë) automjete të blindura, me norma blindimi sipas normave Europiane të UNI EN 1522, dhe UNI EN 1063 për automjete të blinduar si më poshtë.
 - Për Filialin Tiranë 8 mjete të blinduara, 2 (dy) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi BR6, 2 (dy) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi jo më të vogël se BR5, 2 (dy) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi jo më të vogël se BR4 dhe 2 (dy) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi jo më të vogël se BR3, sipas normave Europiane të UNI EN 1522, dhe UNI EN 1063 për automjete të blinduar.
 - Për Filialin Durrës 4 mjete të blinduara, 1 (një) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi BR6, 2 (dy) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi jo më të vogël se BR4 dhe 1 (një) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi jo më të vogël se BR3, sipas normave Europiane të UNI EN 1522, dhe UNI EN 1063 për automjete të blinduar.
 - Për Filialin Shkodër 4 mjete të blinduara, 1 (një) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi BR6, 2 (dy) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi jo më të vogël se BR4 dhe 1 (një) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi jo më të vogël se BR3, sipas normave Europiane të UNI EN 1522, dhe UNI EN 1063 për automjete të blinduar.
 - Për Filialin Lezhë 4 mjete të blinduara 1 (një) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi BR6, 2 (dy) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi jo më të vogël se BR4 dhe 1 (nji) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi jo më të vogël se BR3, sipas normave Europiane të UNI EN 1522, dhe UNI EN 1063 për automjete të blinduar.
 - Për Filialin Fier 3 mjete të blinduara 1 (një) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi BR6, 2 (dy) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi jo më të vogël se BR4, sipas normave Europiane të UNI EN 1522, dhe UNI EN 1063 për automjete të blinduar.
 - Për Filialin Berat 3 mjete të blinduara 1 (një) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi jo më të vogël se BR4 dhe 2 (dy) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi jo më të vogël se BR3, sipas normave Europiane të UNI EN 1522, dhe UNI EN 1063 për automjete të blinduar.
 - Për Filialin Vlorë 3 mjete të blinduara 2 (dy) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi jo më të vogël se BR4 dhe 1 (një) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi jo më të vogël se BR3, sipas normave Europiane të UNI EN 1522, dhe UNI EN 1063 për automjete të blinduar.

-
- Për Filialin Gjirokastrë 3 mjete të blinduara 1 (një) prej automjeteve të blinduara duhet të jetë me normë blindimi jo më të vogël se BR4 dhe 2 (dy) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi jo më të vogël se BR3, sipas normave Europiane të UNI EN 1522, dhe UNI EN 1063 për automjete të blinduar.
 - Për Filialin Elbasan 5 mjete të blinduara 2 (dy) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi BR6, 2 (dy) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi jo më të vogël se BR4 dhe 1 (një) prej automjeteve të blinduara duhet të jetë me normë blindimi jo më të vogël se BR3, sipas normave Europiane të UNI EN 1522, dhe UNI EN 1063 për automjete të blinduar.
 - Për Filialin Kukës 2 mjete të blinduara, 1 (një) prej automjeteve të blinduara duhet të jetë me normë blindimi jo më të vogël se BR4 dhe 1 (një) prej automjeteve të blinduara duhet të jetë me normë blindimi jo më të vogël se BR3, sipas normave Europiane të UNI EN 1522, dhe UNI EN 1063 për automjete të blinduar.
 - Për Filialin Mat 3 mjete të blinduara 1 (një) prej automjeteve të blinduara duhet të jetë me normë blindimi jo më të vogël se BR4 dhe 2 (dy) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi jo më të vogël se BR3, sipas normave Europiane të UNI EN 1522, dhe UNI EN 1063 për automjete të blinduar.
 - Për Filialin Korçë 4 mjete të blinduara, 1 (një) prej automjeteve të blinduara duhet të jetë me normë blindimi BR6, 2 (dy) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi jo më të vogël se BR4 dhe 1 (një) prej automjeteve të blinduara duhet të jetë me normë blindimi jo më të vogël se BR3, sipas normave Europiane të UNI EN 1522, dhe UNI EN 1063 për automjete të blinduar.
 - Për Filialin Sarandë 2 mjete të blinduara duhet të jenë me normë blindimi jo më të vogël se BR4, sipas normave Europiane të UNI EN 1522, dhe UNI EN 1063 për automjete të blinduar.
 - Për Filialin Lushnjë 2 mjete të blinduara duhet të jenë me normë blindimi jo më të vogël se BR4, sipas normave Europiane të UNI EN 1522, dhe UNI EN 1063 për automjete të blinduar.
 - Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 50 (pesëdhjetë) shofer për drejtimin e mjeteve të blinduara emrat e të cileve të figurojnë tek Autorizimet e Mjeteve të blinduara të lëshuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, në përputhje me numrin e mjeteve të blinduara të kërkuara për çdo qark.
 - Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 2 (dy) kuti (valixhe) për mbajtjen e banknotave me boje ngjyrosje për përballimin e situatave të emergjencave. Për të vërtetuar këtë operatori duhet të paraqesë faturën tatimore për blerjen dhe pagesën që vërteton vlerën e blerjes ose deklaratën doganore të mallit.
 - Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim performancë 1.3.B jo më parë se muaji Maj 2025, nga Drejtoritë e Policisë së Qarkut ku të ketë punonjës të certifikuar në kategorinë 1.3.B, përkatesisht për: Tiranë 20 punonjës të certifikuar, Durrës 8 punonjës të certifikuar, Shkodër 8 punonjës të certifikuar, Lezhë 6 punonjës të certifikuar, Fier 4 punonjës të certifikuar, Berat 6 punonjës të certifikuar, Vlorë 6 punonjës të certifikuar, Gjirokastrë 6 punonjës të certifikuar, Elbasan 10 punonjës të certifikuar, Kukës 4 punonjës të certifikuar, Mat 6 punonjës të certifikuar, Korçë 10 punonjës të certifikuar, Sarandë 4 punonjës të certifikuar dhe Lushnjë 4 punonjës të certifikuar konform, ligjit *nr.75/2014 datë 10.07.2014*) të ndryshuar si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Këto

vërtetime duhet të përmbajë informacionin dhe opinionin që disponon DPQ-ët sa më poshtë për: -Qendra e kontrollit të Shërbimeve (Sallë Operative) Të mos ketë marrë masë administrative për (operatorin ekonomik, Titullar dhe drejtues Teknik).

- Operatori Ekonomik të disponojë Qendër Kontrolli, për të vërtetuar këtë pikë të paraqes akt miratimi sipas Udhëzimit Nr.130 dt. 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm “Për Funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike” për dymbëdhjetë qarqe të lëshuar nga DPQ-ët (Tiranë, Durrës, Shkodër, Lezhë, Fier, Berat, Vlorë, Gjirokastrë, Elbasan, Kukës, Dibër dhe Korçë).

Me qëllim parandalimin e veprimeve kriminale Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kapacitete sipas qarqeve si më poshtë :

- Për Filialin Tiranë faturë tatimore blerje ose deklaratë doganore të mallit për 8 copë GPS; 8 copë DVR, 32 kamera dhe 16 armë zjarri.
- Për Filialin Durrës faturë tatimore blerje ose deklaratë doganore të mallit për 4 copë GPS; 4 copë DVR, 16 kamera dhe 8 armë zjarri.
- Për Filialin Shkodër faturë tatimore blerje ose deklaratë doganore të mallit për 4 copë GPS; 4 copë DVR, 16 kamera dhe 8 armë zjarri.
- Për Filialin Lezhë faturë tatimore blerje ose deklaratë doganore të mallit për 4 copë GPS; 4 copë DVR, 16 kamera dhe 10 armë zjarri.
- Për Filialin Fier faturë tatimore blerje ose deklaratë doganore të mallit për 3 copë GPS; 3 copë DVR, 12 kamra dhe 6 armë zjarri
- Për Filialin Berat faturë tatimore blerje ose deklaratë doganore të mallit për 3 copë GPS; 3 copë DVR, 12 kamera dhe 6 armë zjarri.
- Për Filialin Vlorë faturë tatimore blerje ose deklaratë doganore të mallit për 3 copë GPS; 3 copë DVR, 12 kamera dhe 6 armë zjarri.
- Për Filialin Gjirokastrë faturë tatimore blerje ose deklaratë doganore të mallit për 3 copë GPS; 3 copë DVR, 12 kamera dhe 6 armë zjarri.
- Për Filialin Elbasan faturë tatimore blerje ose deklaratë doganore të mallit për 5 copë GPS; 5 copë DVR, 20 kamera dhe 10 armë zjarri.
- Për Filialin Kukës faturë tatimore blerje ose deklaratë doganore të mallit për 2 copë GPS; 2 copë DVR, 8 kamera dhe 4 armë zjarri.
- Për Filialin Mat faturë tatimore blerje ose deklaratë doganore të mallit për 3 copë GPS; 3 copë DVR, 12 kamera dhe 6 armë zjarri.
- Për Filialin Korçë faturë tatimore blerje ose deklaratë doganore të mallit për 4 copë GPS; 4 copë DVR, 16 kamera dhe 8 armë zjarri.
- Për Filialin Sarandë faturë tatimore blerje ose deklaratë doganore të mallit për 2 copë GPS; 2 copë DVR, 8 kamera dhe 4 armë zjarri.
- Për Filialin Lushnje faturë tatimore blerje ose deklaratë doganore të mallit për 2 copë GPS; 2 copë DVR, 8 kamera dhe 4 armë zjarri.

Operatori Ekonomik për të vërtetuar faktin e pronësisë së armëve duhet të disponojë gjithashtu dhe dokumentacionin si më poshtë:

- Autorizim nga Drejtoria e Përgjithshme e policisë për blerjen e armëve të zjarrit.
 - Kontrate Shitblerje Armë me një shoqëri të licensuar
 - Fature tatimore për blerjen e armëve.
- Punonjësi i Shërbimit duhet të jetë i aftë të reagojë dhe të vëprojë gjithmonë në përputhje me instruksionet e personave përgjegjës të përcaktuar nga punëdhënësi i tyre.
 - Grupi i shoqërimit të vlerave monetare të SHPRSF-së duhet të jetë i përbërë nga punonjës të certifikuar të kategorive 1.3.B të cilët duhet të jenë të pajisur me mjete mbrojtëse, antipluma,

armë zjarri, municion, pranga, uniformë dhe dokument identifikimi ashtu siç parashikohet në Ligjin Nr.75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” si dhe udhëzimet në fuqi.

- Ky Grup duhet të shoqëroje vlerat monetare që i janë besuar dhe të siguroj jetën e personelit gjatë transportit të vlerave monetare. Detyra e tij funksionale është Shoqërimi i sigurtë i vlerave monetare dhe punonjësve nga Filialet e Postës sh.a., drejt filialeve të Bankave respektive sipas zgjedhjes ose drejtyrave postare.
- Për transportin e vlerave monetare ofertuesi duhet të pajisë punonjësit e shërbimit me armë sipas përcaktimeve ligjore të Ligjit Nr.75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”.
- Shoqërimi dhe transportimi duhet të kryhet nga mjeti i Blinduar i kompanise, mjeti duhet të jetë i blinduar, i loguar në gjëndje të rregullt teknike dhe dokumentare që të kryejë shoqërimin e transportimin e vlerave monetare. Automjetet e blinduara që transportojnë vlera monetare e sende të çmuara duhet të jenë në përputhje me standartet e kërkuara. Automjetet e blinduara që transportojnë vlera monetare e sende të çmuara sipas kerkese te AK, duhet të qarkullojnë në të gjitha rrugët e asfaltuara te përcaktuara në grafik nga AK.
- Shoqërimi i vlerave monetare do të kryhet sipas vëndndodhjes së filialeve, degëve dhe zyrave postare te **Postës Shqiptare sh.a.**, të përcaktuar në Tabelën e publikuar nga Autoriteti Kontraktor dhe në zbatim të plotë të instruksioneve të personave përgjegjës të **Postës Shqiptare sh.a.**, me grafik shërbimi përkatësisht nga dita e Hënë–Premte dhe për qytetin e Tiranës nga dita e Hënë-e Shtunë.

- Koha orare e shoqërimit të vlerave monetare do të jetë :

- Ora 08.00-16.00
- Raste të vecanta orar i fillimit të lëvizjeve do të jetë më herët se orari sipërcituar sipas specifikës së filialit në qytetin e postës sugjeruar nga AK.

- Punonjesi i Shërbimit duhet të jetë i aftë të reagojë dhe të vëprojë gjithmonë në përputhje me instruksionet e personave përgjegjës të përcaktuar nga **Postës Shqiptare sha**.
- Punonjesit e Shoqërisë SHPSF që kryejnë Shoqërimin e vlerave monetare duhet të jenë të pajisur me armatim sipas ligjeve në fuqi dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Brëndshëm “Për Funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike” si dhe me mjete speciale për përballimin e situatave nga sulme të mundshme me qëllim grabitjen e vlerave monetare (Jelek antiplumb, radio, pranga etj).
- Grupet e shoqërimit të vlerave monetare të SHPSF - se duhet të kenë përbërjen sic përcaktohet në Udhëzimin e Ministrit të Brëndshëm Nr.130 datë 05.03.2018 ose cdo udhëzimi tjetër që del “Për Funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”.
- Shoqëria private për të siguruar shoqërimin dhe transportin e vlerave monetare dhe për realizimin me korrektesi të detyrës duhet të vere në dispozicion të punonjësve armatim dhe pajisje të shërbimit si më poshtë:

- Armatim personal sipas Ligjit "Për Armët".
- Jelek antiplumb;
- Hekura lidhës;
- Shkop gome;
- Radio ndërlidhje;

- Të gjithë punonjësit e shërbimit në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Brëndshëm “Për Funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”, duhet të mbajnë dokumentin e identifikimit në vënd të dukshëm dhe vetëm gjatë kryerjes së detyrës ata detyrohen ta

paraqesin atë sa herë u kërkohet për identifikim nga strukturat e policisë apo organet e tjera ligjzbatuese.

- Të gjithë punonjësit e ofruesit të shërbimit të kërkuar duhet të jenë të pajisur me uniformën operacionale me elementët përbërës dhe të gjitha materialet e nevojshme logjistike sipas Ligjit Nr.75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” dhe të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brëndshëm si dhe cdo udhëzimi tjetër që del Për Funksonimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike
- Gjithashtu në zbatim të Nenit 27 pika c, e Ligjit Nr.75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”, punonjësi i shërbimit ka përgjegjësi të mbajë sipas rregullores armatimin personal dhe pajisjet e shërbimit, të përdorë uniformën, shenjat dhe simbolet e SHPSF-së vetëm gjatë kryerjes së detyrës si dhe përdorë armën sipas legjislaçionit në fuqi.
- Në lidhje me përdorimin e forcës, punonjësit e shërbimit duhet të zbatojnë Nenin 33 të Ligjit Nr.75/14 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” ku përcaktohet qartë se: *“Punonjësi i Shërbimit i SHPSF-së përdor forcën fizike dhe pajisjet e mjetet e tjera, të dhëna për përmbushjen e detyrës, vetëm kur kjo është e nevojshme dhe nëse masat e tjera nuk kanë dhënë rezultat, në përputhje me kriteret e përshkallëzimit të saj. Punonjësi i shërbimit përshkallëzon nivelin e nevojshëm të përdorimit të forcës, duke filluar nga bindja me fjalë, shtrëngimi fizik, deri të shkopi i gomës. Punonjësi i shërbimit duhet të paralajmërojë se do të përdorë forcën para përdorimit të saj”*.
- Me qëllim parandalimit e veprimeve kriminale, të gjithë punonjësit të shërbimit të SHPSF-së duhet të zbatojnë me përpikëri rregullat si më poshtë:
 - a) Rregulloren e përbashkët të funksionimit të shërbimit në transportin e vlerave ;
 - b) Librin e instruktazhit me pjesë nga aktet normative;
 - c) Rregulloren e **Postes Shqiptare sh.a.** dhe Rregulloren e SHPSF-se për funksionimit të shërbimit privat në transportin e vlerave;
- Drejtuesi Teknik i SHPSF-së është drejtuesi më i lartë teknik i shoqërisë dhe do të përgjigjet për organizimin, drejtimin, kontrollin e kryerjes së shërbimit për shoqërimin dhe sigurimin e vlerave monetare gjatë transportit. Ai duhet të përcaktojë rregullat e funksionimit të SHPSF-së në lidhje me shoqërimin e vlerave monetare në lëvizje, si dhe të përpilojë plandislokimin për çdo objekt së bashku me skemat e ruajtjes dhe plane të veçanta ruajtjeje.
- Transporti i vlerave monetare do të kryhet nga e Hëna në të premte sipas intenerareve nga arka drejt filialeve qendrore të postave ose bankave të nivelit të II për të gjitha ditët e vitit nga e hëna në të premte dhe ditën e shtunë vetëm për qytetin e Tiranës. Oraret e lëvizjes do të jenë nga ora 08⁰⁰-16⁰⁰ dhe; Raste të veçanta orar i fillimit të lëvizjeve do të jete me heret se orari sipërcituar sipas specifikës së filialit të postës sipas AK.

Tabela shtojca 1/1

Referuar tabelës më sipër, preket janë për një muaj dhe pagesat do të bëhen në muaj.

- Operatorët ekonomik, krahas formularit të ofertës, duhet të paraqesin tabelën e detajuar me formën si më poshtë, ku të përfshihen të gjitha detyrimet sipas legjislaçionit në fuqi për të gjithë grupin e punonjësve për lëvizjet sipas destinacionet e kërkuara në tabele duhet të parashikojnë paga bazë mujore, leje e zakonshme, shtesa për paaftësi në punë (raporte), sigurimet shoqërore, tarife arme, shpenzime uniforme, radio, shpenzime administrative, lënde djegëse, taksa e mjeteve, mirëmbajtje, siguracion dhe fitim të shoqërisë. Mosparaqitja e kësaj tabele dhe ofertimi nën koston minimale ligjore përbën shkak për skualifikimin e operatorëve ekonomik.

NR TOTAL I ZYRAVE	NR	DEGET	DREJTIMET E LEVIZJEVE	Numeri I prekjeve ne muaj
		1	BURRELI	73
1	1	BURRELI	Bank –Filial	20
2	2		Z.P Burrel - Baz	5
3	3		Filial–Zyra Pensione	10
4	4		Z.P Burrel - Ulëz	3
5	5		Z.P Burrel - Koms	5
6	6		Z.P Burrel - Gurrë	5
7	7		Z.P Burrel - Klos	12
8	8		Z.P Burrel – Xibër	4
9	9		Z.P Burrel – Suç	5
10	10		Z.P Burrel - Lis	4
		BULQIZË	BULQIZA	57
11	1		Bank-Bulqizë Qendër	15
12	2		Bulqizë Qendër - Z.P Bulqizë 1	10
13	3		Bulqizë - Fushë Bulqizë	5
14	4		Bulqizë – Z.P Zerqan	6
15	5		Bulqizë – Z.P Shupenzë	8
16	6		Bulqizë – Z.P Gjoricë	8
17	7		Bulqizë – Z.P Ostren	5
			DIBËR	80

- Transporti i vlerave monetare do të kryhet nga dita e hënë në ditën e premte sipas intenerareve nga arka drejt filialeve qendrore të postave ose bankave të nivelit të II-të për të gjitha ditët e vitit nga e hëna në të premte dhe ditën e shtunë vetëm për qytetin e Tiranës. Oraret e levizjes

18	1	DIBËR	Bankë BKT – Qendër Peshkopi	10
19	2		Bankë Cr – Qendër Peshkopi	10
20	3		Z.P Peshkopi - Maqellarë	15
21			Peshkopi – Z.P Peshkopi 1	13
22	6		Z.P Peshkopi - Kastriot	10
23	7		Z.P Peshkopi - Fushë Çidhen	5
24	8		Z.P Peshkopi - Slllovë	5
25	9		Z.P Peshkopi - Kala e Dodës	4
26	10		Z.P Peshkopi - Muhur	4
27	11		Z.P Peshkopi - Arras	4
		MAT	TOTALI	210
